





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
GJYKATA KUSHTETUESE


Buletini periodik i Gjykatës Kushtetuese

Vendimet shtator-tetor 2025



Buletini periodik i vendimmarrjes
Nr. 5 , shtattor-tetor 2025
© Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë





HYRJE

Në kuadër të komunikimit të vazhdueshëm me publikun dhe median, të garantimit të transparencës, si dhe të rritjes së aksesit në Gjykatën Kushtetuese, si një nga parimet më të rëndësishme dhe thelbësore të administrimit të drejtësisë, Gjykata publikon Buletinin Periodik të vendimmarrjes së saj. Ai ka si qëllim informimin dhe njohjen e praktikantëve të së drejtës, studiuesve të ligjit, e çdo lexuesi, me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, dhe me qëndrimet e mbajtura prej saj. Kështu, botimi i sjell vendimet në mënyrë të përmbledhur dhe me një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për lexuesin. Për secilën prej tyre, paraqiten faktet që lidhen me çështjen konkrete, vlerësimi i Gjykatës lidhur me pretendimet e kërkuarit, ashtu edhe vendimmarrja e mënyra e votimit.

Në këtë numër do të gjeni të gjitha vendimet përfundimtare të dhëna gjatë periudhës shtator-tetor 2025.

PËRMBAJTJA

Kontroll i akteve normative	4
Gjykim incidental	9
Ankim kushtetues individual (vendime përfundimtare)	11

Parimi i shtetit të së drejtës – Liria e veprimtarisë ekonomike e lidhur me parimin e proporcionalitetit dhe barazisë përpara ligjit si dhe mosdiskriminimit – Akti normativ me fuqinë e ligjit

FJALË KYÇE

Profesioni i mjekut/ proporcionaliteti i masës/ diskrecion i titullarit/ ent publik jobuxhetor/ shkelje disiplinore/ sistem shëndetsor publik/ autonomi spitalore

Autonomia dhe pavarësia e Urdhrit të Mjekëve nuk përjashton ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse të shtetit në fushat ku realizohet një interes publik.

Vetë balanca midis interesit publik dhe së drejtës individuale ruhet përmes respektimit të detyrimeve të mjekut ndaj institucionit publik dhe rregullave mbi konfliktin e interesit, pa pasur nevojë për një autorizim paraprak nga titullari.

Çdo ndërhyrje që prek ushtrimin e së drejtës për të ushtruar profesionin duhet të bazohet në norma të qarta, të kuptueshme dhe të parashikueshme, në mënyrë që individit (mjeku në rastin konkret) të mund të dijë paraprakisht pasojat disiplinore të veprimeve ose mosveprimeve të tij.

Sindikata e Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor, Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë (liria për të ushtruar profesionin e mjekut) - vendimi nr. 58, datë 15.10.2025

Faktet

Kuvendi miratoi ligjin nr. 123, datë 25.09.2014 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë” dhe më pas Këshilli i Ministrave miratoi aktin normativ nr. 2/2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 123/2014 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë””. Më tej, Kuvendi me ligjin nr. 94/2024 miratoi aktin normativ me fuqinë e ligjit. Shtesat dhe ndryshimet e këtyre akteve lidheshin me kompetencat dhe organet e Urdhrit të Mjekëve, kriteret e anëtarësisë, ndërprerjen e saj, detyrimet e anëtarëve, kushtet e ushtrimit të profesionit, përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar, funksionet e këshillave rajonale, komisionet disiplinore, masat disiplinore dhe ankimi gjyqësor. Gjithashtu, me vendimin nr. 85, datë 05.02.2025 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Disiplinës dhe të Komisionit të Apelimit” u përcaktuan edhe rregullat për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Disiplinës dhe të Komisionit të Apelimit, kryerjen e një procesi të rregullt ligjor për shqyrtimin e pretendimeve për shkelje disiplinore dhe zbatimin e masave disiplinore që zbatoheshin për mjekët që ushtrojnë profesionin në institucionet shëndetësore publike dhe jopublike në Republikën e Shqipërisë.

Sindikata iu drejtua Gjykatës për shfuqizimin e aktit normativ ose në alternativë shfuqizimin e disa neneve të tij, ose deklarimin e ometimit ligjor të mundësisë së mjekëve që punojnë në strukturat spitalore me autonomi të plotë financiare të zgjedhin midis raportit të punës me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, si dhe trajtimin me pagesë suplementare për mjekët që zgjedhin raport pune ekskluziv me strukturën spitalore publike. Kërkuesi tjetër, Urdhri i Mjekëve, iu drejtua Gjykatës për shfuqizimin e aktit normativ dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave. Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi bashkimin e çështjeve në një të vetme.

Vlerësimi i Gjykatës

Parimi i shtetit të së drejtës – Gjykata ka pohuar se shteti ushtron funksionet e tij, jo vetëm nëpërmjet institucioneve shtetërore, por në një farë mase edhe nëpërmjet organizimeve të tjera joshëtitërore të cilat ushtrojnë me ligj funksioneve publike të caktuara. Urdhri i Mjekëve ndonëse është një person juridik i së drejtës publike i krijuar me ligj, ushtron kompetenca që ndikojnë drejtpërdrejt në realizimin e objektivave sociale të shtetit në fushën e shëndetësisë, çka do të thotë se ai ushtron funksione të një natyre publike, prandaj edhe ndaj tij duhet të garantohet një sistem vetërregullimi dhe vetëqeverisjeje. Gjykata çmon se përfshirja e ministrisë përkatëse në organizimin dhe funksionimin e komisioneve të disiplinës të Urdhrit të Mjekëve, si dhe në procesin e miratimit të Kodit të Etikës, përbën një masë të arsyeshme dhe proporcionalisht të justifikuar të mbikëqyrjes shtetërore, ndërhyrje kjo që gjen mbështetje në natyrën publike të funksionit që ushtron Urdhri i Mjekëve. Kjo pjesëmarrje nuk cenon pavarësinë funksionale të Urdhrit të Mjekëve, por synon të krijojë një ekuilibër ndërmjet autonomisë profesionale dhe përgjegjësisë publike në mbrojtje të interesit publik. Gjykata arrin në përfundimin se organizimi i miratuar nga akti normativ objekt kundërshtimi nuk përbën ndërhyrje të pajustificuar në autonominë e Urdhrit të Mjekëve, por është një mekanizëm kontrolli që i shërben zbatimit të detyrimeve kushtetuese të shtetit në mbrojtje të sigurimit të standardeve të larta shëndetësore. Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të shtetit të së drejtës është i pabazuar.

Liria e veprimtarisë ekonomike e lidhur me parimin e proporcionalitetit dhe barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit –

Për kufizimin 30% të orëve mujore – Gjykata, në lidhje me këtë pretendimin të kërkuarve, në përfundim të diskutimeve, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje dhe pretendimi për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike për shkak të kufizimit 30% konsiderohet i rrëzuar.

(vijon në faqen 5)



Për detyrimin për t'i bërë kërkesë titullarit për të ushtruar profesionin e mjekut në një institucion shëndetësor jopublik – Gjykata thekson, se për sa kohë ushtrimi i veprimtarisë në një institucion shëndetësor jopublik nuk pengon kryerjen e detyrave në institucionin publik dhe nuk krijon konflikt interesi, nuk ekziston ndonjë arsye kushtetuese që ta kushtëzojë këtë me dhënien e një lejeje administrative. Mungesa e detyrimit për arsyetimin e vendimit dhe pamundësia e një mjeti efektiv ankimi e bën këtë kompetencë të titullarit diskrecionale dhe nuk ofron garancitë e nevojshme procedurale. Gjykata çmon se kufizimi që vendos ky nen nuk përmbush kriterin e proporcionalitetit ndërmjet qëllimit publik të garantimit të standardeve më të larta shëndetësore dhe ushtrimit të lirë të profesionit nga mjekët. Nga njëra anë, ligji njeh mundësinë e dypunësimit të mjekëve dhe nga ana tjetër i jep titullarit një kompetencë vendimmarrëse që praktikisht e bën këtë të drejtë të pamundur për t'u realizuar. Detyrimi për të marrë leje nga titullari, është i tillë që, në praktikë, mund të çojë në mohimin e plotë të së drejtës për të ushtruar profesionin në sektorin shëndetësor jopublik, duke e bërë kufizimin joproporcional në raport me qëllimin e ndjekur. Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike është i bazuar.

Për cenimin e së drejtës për punë dhe ushtrimin e një profesioni të lidhur me parimin e proporcionalitetit- Gjykata vlerëson se dispozita në fjalë nuk përmbush standardin e qartësisë dhe të parashikueshmërisë së ligjit. Dispozita e ndryshuar e nenit 17 të ligjit nr. 123/2014, në pjesën që parashikon aplikimin e masës disiplinore, heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit, nuk plotëson standardin kushtetues të qartësisë dhe të parashikueshmërisë. Parashikimi në aktin normativ i masës disiplinore të heqjes së licencës në mënyrë të përhershme dhe pa përcaktuar kriteret e qarta, për të cilat kjo masë mund të jepet, shkon përtej karakterit të dënimit penal dhe për këtë arsye cenon në thelb të drejtën për punë dhe ushtrimin e një profesioni. Pretendimi i kërkuesve në këtë drejtim është i bazuar, prandaj Gjykata vlerëson se shkronja "d" e pikës 1 të nenit 17 dhe fjalia e fundit e pikës 3 të po këtij neni, ndryshuar me nenin 10 të aktit normativ duhet të shfuqizohen.

Për cenimin e nenit 101 të Kushtetutës – Lidhur me këtë pretendim për cenimin e nenit 101 të Kushtetutës për shkak të miratimit të aktit normativ në mungesë të kushteve të nevojës dhe urgjencës, në përfundim të diskutimeve, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje dhe pretendimi u konsiderua i rrëzuar.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin pjesërisht të kërkesës.

Konflikt kompetencash – Parimi i përtëritjes periodike të pjesshme të Gjykatës Kushtetuese – Parimi i kohëzgjatjes së mandatit të gjyqtarit kushtetues – Parimi i kushtetutshmërisë

FJALË KYÇE

Luajtjet kushtetues/ reforma kushtetuese/ dispozitë kalimtare/ regjim tranzitor/ organ emërtese/ kohëzgjatje e mandatit/ mbarimi dhe fillimi ideal i mandatit/ mekanizimi i përtëritjes së pjesshme (rotacionit)/ intervale kohore të përtëritjes/ Komisioni i Venecias/ interpretim konstruktiv dhe funksional

Përgjatë regjimit tranzitor, sipas nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, kohëzgjatja e mandateve kushtetuese të gjyqtarëve të emëruar/ zgjedhur në detyrë nuk i nënshtrohet parashikimeve të regjimit të përhershëm kushtetues që rregullohet sipas neneve 125, pika 3 dhe 129 të Kushtetutës.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë (interpretimi i dispozitave kushtetuese që sanksionojnë parimet e përtëritjes periodike të pjesshme dhe kohëzgjatjes së mandatit të gjyqtarit kushtetues) - vendimi nr. 60 , datë 16.10.2025

Faktet

Me vendimin nr. 84, datë 23.12.2024, Gjykata vendosi të deklarojë mbarimin e mandatit të gjyqtarës kushtetuese të zgjedhur me mandat të pjesshëm deri në vitin 2025, sipas parashikimeve të dispozitës tranzitore, nenit 179, pika 3, të Kushtetutës. Për qëllim të kësaj vendimmarrjeje Gjykata u ndal edhe në mënyrën se si duhet të sillen organet e emërtesës në rast se vetë ajo nuk vihet në lëvizje për ushtrimin e kësaj kompetence, ashtu edhe në interpretimin e dispozitës kushtetuese që rregullon regjimin tranzitor të përtëritjes periodike së saj.

Pasi u njoh me këtë vendim, Presidenti, në cilësinë e njërit prej tre organeve të emërtesës, iu drejtua Gjykatës me kërkesë me objekt deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues emërtesë e tij. Bazuar në interpretimin e Gjykatës në vendimin e sipërcituar, Presidenti kërkoi, në thelb, zgjidhjen e konfliktit të kompetencës mes tij dhe Gjykatës, të shkaktuar nga mosveprimi i kësaj të fundit për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, çka e vinte atë në pamundësi të ushtronte kompetencën kushtetuese si organ emërtesë. Për këtë shkak ai kërkoi edhe interpretimin përfundimtar të normave kushtetuese.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata pasi evidentoi se Presidenti ka parashtruar dy kërkitime, të cilat përbëjnë çështje të ndryshme kushtetuese, vlerësoi se ai për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues do të shqyrtohet veçmas, duke pasur parasysh se është një gjykim me natyrë deklarative, që zhvillohet pa palë ndërgjyqëse dhe nuk kërkon debat gjyqësor.

Për sa i përket kërkitimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave, Gjykata konstatoi se në dukje ka lindur një mosmarrëveshje midis subjekteve kushtetuese, Presidentit dhe Gjykatës, për shkak të mënyrës së ndryshme të të kuptuarit të nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, çka është evidentuar edhe nga subjekti i interesuar, Kuvendi, si një nga tre organet kushtetuese të emërtesës, i cili, nga ana e tij, ka bërë një interpretim të ndryshëm gjatë shpalljes së mandatit plotësues emërtesë e tij. Ky konflikt, në thelb, ka ardhur për shkak të zbatimit dhe konkurrimit të dy parimeve kushtetuese, atij të përtëritjes periodike të pjesshme të Gjykatës çdo tre vjet me një të tretën dhe atij të kohëzgjatjes së mandatit të gjyqtarit kushtetues, ndaj për zgjidhjen e tij bëhet i nevojshëm interpretimi përfundimtar i dispozitave kushtetuese lidhur me ndërveprimin e këtyre parimeve.

Në lidhje me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të dispozitave që sanksionojnë këto parime kushtetuese, Gjykata vlerësoi se regjimi tranzitor që parashikon dispozita kalimtare, neni 179, pika 3, i Kushtetutës është i zbatueshëm për të gjitha mandatet e gjyqtarëve kushtetues në detyrë në momentin e miratimit të tij. Përmes kësaj dispozite kushtetutëbërësi ka synuar të garantojë përtëritjen e rregullt të përbërjes së Gjykatës, parim ky i sanksionuar në nenin 125, pika 6, të Kushtetutës. Për gjyqtarët në regjimin tranzitor sipas pikës 3 të nenit 179 të Kushtetutës ky parim mbizotëron në raport me parimin e kohëzgjatjes së mandatit, i cili ka qenë i kufizuar në kohë që në krye të herës, duke qenë ky interpretimi i vetëm që do të garantonte qëllimin kryesor të dispozitës kalimtare, nenit 179, pika 3, të Kushtetutës. Përcaktimi në dispozitën kalimtare të dy mandateve më të shkurtra se 9 vjet, konkretisht ato që mbarojnë në vitin 2025 dhe vitin 2028, i shërben dhe është në funksion të garantimit të parimit të përtëritjes së rregullt.

(vijon në faqen 7)

Në funksion të zbatimit të parimit kushtetues të përtëritjes periodike të pjesshme të Gjykatës, është pasur në konsideratë lidhja mes mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës dhe fillimit (ideal) të qëndrimit në detyrë të gjyqtarit të ri, e reflektuar edhe në parashikimin e pikës 4 të nenit 86 të Ligjit Organik të Gjykatës, që përcakton skemën kohore të përtëritjes së përbërjes: përtëritja e parë me një të tretën në vitin 2025; përtëritja e dytë me një të tretën në vitin 2028; përtëritja e tretë me një të tretën në vitin 2031.

Përgjatë këtij regjimi tranzitor, fillimi i mandatit të gjyqtarit kushtetues përkon me datën e deklaruar ose që duhej deklaruar nga Gjykata dhe jo nga ndonjë organ tjetër kushtetues të mbarimit të mandatit kushtetues të gjyqtarit që ai zëvendëson.



Në funksion të zbatimit të parimit kushtetues të përtëritjes periodike të pjesshme të Gjykatës, nga kushtetutëbërësi duket se është pasur në konsideratë lidhja mes mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës dhe fillimit (ideal) të qëndrimit në detyrë të gjyqtarit të ri, e reflektuar kjo edhe në parashikimin e pikës 4 të nenit 86 të Ligjit Organik të Gjykatës. Ndonëse kjo dispozitë nuk parashikon shprehimisht kohën e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, referuar skemës kohore të përtëritjes së përbërjes së Gjykatës, sipas së cilës përtëritja e parë me një të tretën bëhet në vitin 2025, përtëritja e dytë me një të tretën bëhet në vitin 2028 dhe përtëritja e tretë me një të tretën bëhet në vitin 2031, përgjatë këtij regjimi tranzitor, fillimi i mandatit të gjyqtarit kushtetues përkon me datën e deklaruar ose që duhej deklaruar nga Gjykata dhe jo nga ndonjë organ tjetër kushtetues të mbarimit të mandatit kushtetues të gjyqtarit që ai zëvendëson.

Parashikimi në skemën e përtëritjes së Gjykatës përgjatë regjimit tranzitor i mundësisë që gjyqtari kushtetues të ushtrojë detyrën për një kohëzgjatje më të shkurtër se mandati kushtetues 9-vjeçar, gjen mbështetje kushtetuese dhe është e lejueshme nga vetë kushtetutëbërësi, për sa kohë reflekton vetë konceptin e tij kushtetues, me qëllim garantimin e parimit të përtëritjes periodike të pjesshme. Ky lloj kuptimi nuk e shfuqizon afatin 9-vjeçar të ushtrimit të detyrës, por e lidh zbatimin e tij si një proces gjithëpërfshirës me periudhat e përtëritjes të Gjykatës.

Në përfundim, Gjykata vlerësoi se e vetmja mënyrë për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave është deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues emërtesë e Presidentit (kërkuesit), që për shkak të natyrës deklarative do të shqyrtohet veçmas.

Në përputhje me interpretimin e saj të normave kushtetuese Gjykata vlerësoi edhe se Kuvendi duhet të marrë masat për të garantuar respektimin e përtëritjes së pjesshme të saj në vitin 2025, duke rishpallur procedurat për zgjedhjen e gjyqtarit të ri kushtetues, pjesë e kuotës së tij.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri: kompetenca për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues i përket asaj dhe vetëm pas kësaj organi i emërtesës ushtron kompetencën e emërimit/zgjedhjes; shqyrtimin veçmas të kërimit për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues.

Gjykata vendosi, me shumicë votash, interpretimin e nenit 179, pika 3, të Kushtetutës.



Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit

FJALË KYÇE

Mjete/ kategoritë e motomjeve/ leje drejtimi/ rregulla të qarkullimit rrugor/ kufizim moshe për drejtimin e mjetit/ drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt/ neni 291 i Kodit Penal/ Kod Rrugor

Përkufizimi i një rregullimi juridik, nëse është ose jo objektivist i arsyetuar, nuk është vetëm një çështje e thjeshtë juridike, por kërkon edhe një vlerësim real. Diferencimet, si dhe arsyet që çojnë tek to ose kundër tyre duhen ballafaquar për t'ia lënë në dorë përfundimisht vendimin organit kompetent, sipas kritereve të tij. Mënyra e zgjidhjes është një e drejtë e organit përkatës, sepse çdo çështje ka specifikat e saj.

Gjykata vlerëson të theksojë se edhe sipas nenit 54 të Kushtetutës të rinjtë kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti, që reflektohet edhe në marrjen e masave me natyrë pozitive për t'i mbrojtur ata edhe nga veprime që mund të sjellin pasoja për jetën dhe të ardhmen e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Korçë (vlefshmëri e lejedrejtimit të kategorisë B me kusht moshën 21 vjeç të drejtuesit) - vendimi nr. 49, datë 24.09.2025

Faktet


Prokuroria pranë gjykatës referuese ka regjistruar ndaj shtetasit T.B. procedimin penal për kryerjen e veprës penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal ku parashikohet se “drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara [...] pa dëshminë përkatëse të aftësisë dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet”. Shtetasi T.B. gjatë drejtimit të motomjetit, u përplas me një automjet. Mjeti i drejtuar nga shtetasi T.B. bënte pjesë në kategorinë A1 të motomjeteve dhe shtetasi T.B. ishte i pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B, e cila, sipas shkronjës “ë” të pikës 2 të nenit 123 të Kodit Rrugor “është e vlefshme në territorin kombëtar për të drejtuar mjete rrugore me tri rrota, me fuqi më të madhe se 15 kW, si dhe motomjetet e kategorisë A1, me kusht që mbajtësi i lejedrejtimit të jetë, të paktën, 21 vjeç”. Shtetasi T.B., për shkak se ishte 20 vjeç, nuk kishte lejen përkatëse të drejtimit dhe gjatë gjykimit parashitroi, se edhe pse ishte i pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B, ai di të drejtojë motomjetin e tij të kategorisë A1 dhe se kërkesës për t’u pajisur me lejedrejtimi të kategorisë A1, drejtuesit e autoshkolave e kanë vlerësuar jo të nevojshme, sepse ishte i pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B. Në këtë situatë shtetasi T.B. i kërkoi gjykatës referuese të pezullojë gjykimin dhe t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për t’u shprehur mbi kushtetutshmërinë e shkronjës “ë” të pikës 2 të nenit 123 të Kodit Rrugor. Gjykata referuese vendosi pezullimin e gjykimit të çështjes dhe iu drejtua Gjykatës.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit – Gjykata referuese pretendoi se dispozita trajton në mënyrë të pabarabartë drejtuesit e motomjeteve me drejtuesit e mjeteve të tjera, nuk ka përputhshmëri me legjislacionin evropian, përbën diskriminim të paarsyeshëm dhe se nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive për kufizimin e drejtimit të motomjeteve me moshën 21 vjeç, në kushtet kur drejtuesit e motomjeteve i nënshtrohen të njëjtit testim për marrjen e lejes së drejtimit të kategorisë B, njohin mirë rregullat e qarkullimit rrugor dhe dëshmojnë se kanë aftësi shumë të mira drejtuese edhe për drejtimin e motomjeteve të kategorisë A1. Në këtë rast personat që janë në kushte të njëjta trajtohen ndryshe nga ligji. Dispozita, në paragrafin e dytë, sanksionon ndalimin e diskriminimit, ndërsa paragrafi i tretë mishëron në vetvete kufizimin e kësaj të drejte, por vetëm nëse ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave vendosjen e kushtit të moshës 21 vjeç e pretendoi si një interes publik, të lidhur drejtpërdrejt me sigurinë rrugore ku përfshihen, jo vetëm mbrojtja e jetës, por dhe shëndeti dhe siguria fizike e individëve. Gjykata konstatoi se ligjvënësi duke parashikuar një kufi moshe minimale për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1, që është tre vjet më i lartë se kufiri minimal për drejtimin e mjeteve të kategorisë B, ka synuar të rrisë, jo vetëm nivelin e maturisë në vlerësimin dhe shmangien e rrezikut të mundshëm në qarkullim, por edhe eksperiencën 1-3 vjeçare për ata që kanë marrë lejen e drejtimit të kategorisë A1 në kufirin e moshës minimale ose afër tij (18- 21 vjeç). Gjykata arrin në përfundimin se në rastin konkret kjo ndërhyrje e ligjvënësit ka pasur një përligjje të arsyeshme, të përshtatshme dhe objektive, ndaj pretendimi i gjykatës referuese është i pabazuar.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (një gjyqtar u shpreh me mendim pakice).



E drejta e aksesit substancial në gjykatë – E drejta e pronës

FJALË KYÇE

**Truall në përdorim/
mbivendosje prone/
trashëgimtarë/ ligj nr.
7501/1991 /ligj nr.
7698/1993 /Ish-Komisioni i
Kthimit dhe Kompensimit
të Pronave/ish-Komisioni i
Ndarjes së Tokës /Akti i
marrjes së tokës në
pronësi/ligjshëmëri aktesh**

Gjykata ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Roli i kësaj gjykate, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta.

Në kuadër të së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe në zbatim të parimit të subsidiaritetit, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, duhej t'u jepte përgjigje përfundimtare, në aspektin substancial, pretendimeve të kërkuësve për mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Për rrjedhojë, mungesa e një qëndrimi të Gjykatës së Lartë për problematikat në thelb të mosmarrëveshjes, u ka cenuar atyre të drejtën për akses substancial në atë gjykatë për pretendimet për cenimin e së drejtës së pronësisë.

Drita Pulleja, Gani Qatipi, Luljeta Qatipi, Gazmir Qatipi, Dorina Qatipi, Florian Qatipi (vendime gjyqësore diametralisht të kundërta në drejtim të përcaktimit të mosmarrëveshjes) - vendimi nr. 46, datë 18.09.2025

Faktet

Kërkuësve, me vendimin nr. 220/1995 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP), Tiranë, u është njohur dhe kthyer pronësia e 5000 m² truall sipas ligjit për kthimin e pronave, ndonëse në vitin 1993 ky truall i ishte dhënë fillimisht në përdorim dhe më pas në pronësi subjekteve të interesuara, trashëgimtarëve të shtetasit Nj.Sh., sipas ligjit për tokën. Subjektet e interesuara, të cilat e kishin në përdorim truallin, kanë ngritur padi, me objekt kundërshtimin e vendimit të KKKP-së Tiranë, për pjesën që u kthente kërkuësve truallin prej 5000 m², ndërsa kërkuësit, brenda të njëjtit proces, kanë ngritur kundërpadi, me objekt kthimin e truallit. Procesi gjyqësor ka filluar më 1996 dhe çështja është gjykuar tre herë në shkallë të parë (në vitet 1996, 2000 dhe 2002), gjashtë herë në shkallë të dytë (në vitet 1997, 1998, 2000, 2003, 2007 dhe 2015) dhe pesë herë në Gjykatën e Lartë (në vitet 1997, 1999, 2004, 2014 dhe 2024). Në përfundim të procesit, gjykatat e zakonshme kanë vendosur anulimin e pjesshëm të vendimit të KKKP-së, Tiranë, për pjesën që u kthente kërkuësve truallin (vendimi i vitit 2002 i gjykatës së shkallës së parë), duke u njohur atyre (kërkuësve) të drejtën e kompensimit në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji (vendimi i gjykatës së apelit i vitit 2015). Gjykata e Lartë, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësve. Kërkuësit iu drejtuan Gjykatës, me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën e pronës- Gjykata konstatoi se Gjykata e Lartë me vendimin nr. 966/1999, ka dhënë orientime të detyrueshme për gjykatat e faktit lidhur me vlerësimin e ligjshëmërisë së AMTP-ve dhe të akteve të Komisionit të Tokës së Këshillit të Rrethit Tiranë, për shkak të kontradiktave në përmbajtjen e tyre. Këto orientime janë përsëritur edhe në vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 1118/2004. Në rigjykimin e fundit, gjykata e apelit, edhe pse ka njohur të drejtën e pronësisë së kërkuësve, ka vlerësuar se: (i) në kushtet kur paditësit janë pronarë të ligjshëm të pronës, sipas ligjit nr. 7501/1991, KKKP-ja Tiranë nuk duhet të vendoste kthimin e saj si të lirë, por duhet të vendoste kompensimin e trashëgimtarëve të ish pronarit në një nga format e parashikuara me ligj, dhe se (ii) kërkuësit nuk mund të ngrinin një padi të thjeshtë rivendikimi pa kërkuar më parë pavlefshmërinë e aktit administrativ (AMTP-së).

Në analizë të vendimit të gjykatës së apelit, Gjykata vëren se ajo gjykatë nuk rezulton të jetë shprehur për problematikat e ngritura nga kërkuësit dhe të evidentuara nga Gjykata e Lartë (Kasacioni) në vendimin nr. 966/1999, për ligjshëmërinë e AMTP-ve dhe akteve të Komisionit të Tokës së Këshillit të Rrethit Tiranë, që kanë qenë edhe themeli i mosmarrëveshjes objekt kundërshtimi.

Gjykata e Lartë, duke u ndodhur përpara situatës ligjore ku gjykatat e faktit (dhe vetë Kolegjet e Gjykatës së Lartë) kanë dhënë vendime të kundërta, si dhe nuk janë shprehur, edhe pse kishin detyrimin ligjor, për zbatimin e detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë lidhur me ligjshëmërinë e akteve të marrjes së tokës në përdorim dhe në pronësi, si dhe të akteve të KT-së së Këshillit të Rrethit Tiranë, nuk rezulton t'u ketë dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura nga kërkuësit.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e kërkesës (një gjyqtare, është shprehur me mendim kundër).

E drejta për proces të rregullt ligjor

FJALË KYÇE

Shpenzimet gjyqësore / plotësim vendimi/afat dy-mujor.

Gjykata thekson se në parim çështja e shpenzimeve të përfaqësimit në gjykimin kushtetues të ankimit individual është pjesë e procesit të rregullt ligjor dhe refuzimi për mbulimin e tyre rrezikon të kufizojë në mënyrë të pajustificuar të drejtën e individit për akses në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

Për sa i takon subjektit që ngarkohet për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit, Gjykata vë në dukje se natyra dhe objekti i gjykimit kushtetues ndryshojnë nga gjykimi i zakonshëm, ku në këtë të fundit shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palëve ndërgjyqëse sipas disponimit të gjykatës së zakonshme. Përkundër kësaj, në gjykimin kushtetues individi kërkon të mbrojë të drejtat themelore të shkelura si pasojë e veprimtarisë së autoriteteve publike, ku përfshihet edhe ajo e gjykatave të zakonshme, që i kanë pasjellë atij cenimin e të drejtave themelore, ndaj përgjegjësia në këtë gjykim i takon vetë shtetit.

Tom Dedaj (saktësim dhe plotësim në vendimin e Gjykatës Kushtetuese pas miratimit të shpenzimeve gjyqësore) - vendimi nr. 47, datë 18.09.2025

Faktet

Kërkuesi në datën 09.07.2024 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe shfuqizimin e vendimit të gjykatës së apelit që e kishte rrëzuar atë. Pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, kërkuesi përmes avokatit të tij ka paraqitur parashtrimet shtesë, ku, ndër të tjera, ka kërkuar edhe caktimin e shpenzimeve gjyqësore në ngarkim të KLP-së, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Dibrës. Gjykata, me vendimin nr. 4, datë 21.01.2025 ka vendosur pranimin e kërkesës dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe detyrimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të shqyrtojë çështjen e kërkuesit me përparësi. Ndërkohë, Gjykata nuk është shprehur për kërkimin që lidhej me shpenzimet gjyqësore, në lidhje me të cilat, Mbledhja e Gjyqtarëve në datën 24.06.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata analizoi paraprakisht disa çështje juridike, që kanë të bëjnë me: (i) afatin e paraqitjes së kërkesës për shpenzimet gjyqësore në procesin kushtetues, pra nëse një kërkesë e tillë mund të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual, gjatë gjykimit deri në shpalljen e vendimit apo në çdo kohë, por gjithsesi jo më vonë se 2 muaj nga shpallja e vendimit; (ii) kriteret dhe dokumentet mbi bazën e të cilave caktohet masa e shpenzimeve të përfaqësimit; (iii) subjektin që i ngarkohen shpenzimet e përfaqësimit, në rast pranimit të kërkesës: (a) subjekti i interesuar që është palë e procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e zakonshme; (b) subjekti i interesuar që ka nxjerrë vendimin gjyqësor ose aktin e pushtetit publik, që shfuqizohet nga gjykata; (c) Ministria e Financave, në kushtet kur ligji ngarkon Këshillin e Ministrave që me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore të sigurojë ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës; (iv) mënyrën, afatet dhe procedurën e ekzekutimit të shpenzimeve të përfaqësimit.

Gjykata vëren se ligji nr. 8577/2000 nuk ka parashikuar në mënyrë të shprehur afatin konkret brenda të cilit kërkuesi mund të paraqesë kërkesë për shpenzimet e përfaqësimit, por është mjaftuar me shprehjen “nëse kërkohet nga kërkuesi”. Në vlerësimin e Gjykatës kjo do të thotë se, *së pari*, disponimi për shpenzimet vihet në lëvizje vetëm me kërkesë formale nga ankuesi dhe, *së dyti*, një kërkesë e tillë mund të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual deri kur deklarohet mbyllja e seancës plenare nga Gjykata.

Duke marrë në konsideratë se ankimi kushtetues është paraqitur nga vetë kërkuesi, i cili ka formimin e përvojën e mjaftueshme për të kuptuar çështjen dhe se gjykimi kushtetues i përfunduar me vendimin nr. 4/2025 nuk ka qenë kompleks, Gjykata i vlerëson shpenzimet e përfaqësimit në vlerën 50 000 lekë. Detyrimi për pagimin e kësaj vlere i ngarkohet Ministrisë së Financave.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e pjesshëm të kërkesës*

* Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit përfundimtar nr. 4, datë 21.01.2025 të Gjykatës Kushtetuese, me plotësimin e dispozitivit: “Shpenzimet e përfaqësimit të kërkuesit në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë i ngarkohen Ministrisë së Financave”.

Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit - Standardi i arsytimit të vendimit

FJALË KYÇE

Rihapje e procesit gjyqësor nga GJEDNJ-ja/ ndërhyrje kryesore/ vlerësim i provave/ akt ekspertimi/ mosformim kuorumi/ kthim dhe kompensim i pronës

Gjykata është shprehur se çdo palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta të paraqesë çështjen dhe nuk duhet të gëzojë avantazh mbi palën tjetër, por të përcaktohet një ekuilibër i drejtë midis tyre.

Vendimet e gjykatave të zakonshme nuk duket të kenë mangësi, mungesë ose pamjaftueshmëri arsytimi apo alogjizëm. Po ashtu, ndërsa gjykatat nuk janë të detyruara të japin përgjigje të detajuara për çdo pretendim, nga përmbajtja e vendimeve të tyre del qartë se ato kanë trajtuar çështjet thelbësore të faktit dhe të ligjit të rëndësishme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së parashtruar përpara tyre.

Astrit Meli (cenimi i parimit të barazisë së armëve dhe i standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor) - vendimi nr. 48, datë 22.09.2025

Faktet

Kërkuesi ka paraqitur kërkesë për njohjen dhe kthimin e pronësisë të një sipërfaqeje toke e cila nuk u pranua. Sipërfaqja e pretenduar është njohur dhe kthyer ish-pronarëve, është dhënë në pronësi si kompensim fizik, është tjetërsuar në favor të disa subjekteve të interesuara, si dhe për atë pronë është dhënë leje shesh ndërtimi për dy objekte. Në këtë situatë kërkuesi iu drejtua gjykatës me padi, për njohjen e tij pronar, anulimin e vendimeve mbi kthimin dhe kompensimin e pronës si dhe pavlefshmërinë e të gjitha transaksioneve të bëra me pronën. Subjekti i interesuar B.M. paraqiti kërkesë për ndërhyrje kryesore dhe padi për njohjen pronarë të trashëgimtarëve të shtetasit M.M., babait të tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë vendosi rrëzimin e padisë së kërkuesit si të pabazuar në prova dhe pranimin e padisë së ndërhyrësit kryesor. Mbi ankimin dhe rekursin e paraqitur u vendos lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe mospranimi i rekursit. Vendimet e dhëna u kundërshtuan me ankim kushtetues nga kërkuesi dhe nga subjekti i interesuar N. K. Gjykata Kushtetuese vendosi moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare për subjektin e interesuar N.K., ndërsa për kërkuesin vendosi rrëzimin e kërkesës për shkak se nuk u arrit kuorumi i kërkuar.

Kërkuesi iu drejtua GJEDNJ-së për mohimin e aksesit në gjykatë, mosdhënien e vendimit të arsyetuar sepse nuk u arrit shumica e ligjshme prej pesë gjyqtarësh, mungesën e arsytimit të vendimeve të gjykatave më të ulëta, barazinë e armëve dhe kohëzgjatjen e procesit gjyqësor. GJEDNJ-ja gjeti shkelje për drejtën e kërkuesit për vendim të arsyetuar nga Gjykata dhe nuk gjeti shkelje për mungesën e aksesit në Gjykatën Kushtetuese. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës me kërkesë për rihapjen e procesit, si dhe shfuqizimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe të vendimeve gjyqësore të gjykatave.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e parimit të barazisë së armëve – Kërkuesi pretendoi se mosadministrimi në gjykim i një prove thelbësore, si dhe mosdhënia përgjigje lidhur me këto prova, kishin cenuar parimin e barazisë së armëve nga gjykatat. Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë, ka pranuar çdo kërkesë të kërkuesit për prova dhe ka administruar në gjykim të gjitha provat shkresore të paraqitura nga ai. Nuk është në rolin e gjykatës të veprojë në mënyrë aktive në këtë drejtim, por iu takon palëve barra e provës për të provuar pretendimet e tyre. Kërkuesi nuk tregoi ndonjë kontradiktë në provat dokumentare të palëve, për sheshimin e të cilave gjykatat e faktit duhet të kishin ndërhyrë në kuptim të dispozitës ligjore të referuar nga ai. Argumenti se gjykata ka ngatërruar rolin e saj me atë të ekspertit, duke disponuar me vendim vetëm për atë çka eksperti ka konstatuar, nuk mund të shërbejë për të vënë në dyshim respektimin e parimit të barazisë së armëve. Kërkuesit i janë krijuar mundësi të barabarta për të paraqitur prova dhe për të parashtruar deklaratimet e tij për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore për çështjen. Për rrjedhojë, pretendimi i tij për cenimin e parimit të barazisë së armëve është i pabazuar.

Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor – Kërkuesi ka pretenduar se arsytimi i vendimeve nga gjykatat e faktit është i mangët, përveçse alogjik dhe ato nuk u kanë dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të tij, si dhe kanë mbështetur konkluzionet e tyre vetëm në përfundimet e ekspertit. Në vendimet e tyre gjykatat kanë dalluar provat e kërkuesit në raport me ato të ndërhyrësit kryesor. Fakti që si kërkuesi, ashtu edhe ndërhyrësi kryesor pretendimin për të drejtën e pronësisë e kanë mbështetur në dokumente të të njëjtit lloj dhe që ofronin të dhëna të së njëjtës natyrë (sipërfaqen dhe kufijtë e pronës), nuk i bën kontradiktore arsytimet e gjykatave të faktit, për sa kohë që për arritjen e përfundimeve në lidhje me pretendimet e ndërhyrësit kryesor ato kanë evidencuar se janë mbështetur edhe në prova të tjera. Vendimet e gjykatave të zakonshme përmbajnë mjaftueshëm arsytim në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes dhe zbatimin e ligjit dhe ky përcaktim nga ato i fakteve dhe i zbatimit të ligjit në vijim nuk duket se është dukshëm i gabuar, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e kërkesës për rihapjen e procesit, rrëzimin e kërkesës për pretendimet e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

E drejta e për t'iu drejtuar gjykatës (aksesi) – Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor

FJALË KYÇE

Njoftim i gjykimit/ njoftim me shpallje/ lajthim/ kthim dhe kompensim prone/ rigjykim/ njoftim i datës dhe orës së seancës gjyqësore

E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal.

Mospranimi i rekursit duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin de plano të çështjes dhe me arsytimin e kufizuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit me natyrë kushtetuese, vë në dyshim respektimin e së drejtës së aksesit në atë gjykatë, e cila përfshin edhe të drejtën për të marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e tij.

Kostandin Xholli (mosmarrje dijani për datën dhe orën e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit) - vendimi nr. 50, datë 25.09.2025

Faktet

Kërkuesi iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë për një sipërfaqe toke ndodhur në fshatin Gjinar, Elbasan. Gjykata vendosi vërtetimin e faktit juridik të pronësisë. Kërkuesi iu drejtua për njohjen e pronësisë, ZRKKP-së Elbasan (Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronës Elbasan) e cila vendosi mosnjohjen e së drejtës së pronësisë të subjektit kërkuar. Mbi ankimin drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (sot ATP), Tiranë është vendosur lënia në fuqi e vendimit të ZRKKP-së, Elbasan. Kërkuesi iu drejtua gjykatës me padi për kundërshtimin e vendimeve të ZRKKP-së, Elbasan dhe të ish-AKKP-së, Tiranë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan vendosi pranimin e padisë, anuloi vendimet e ZRKKP-së, Elbasan dhe të ish-AKKP-së, Tiranë dhe njohu të drejtën e pronësisë. Ky vendim prish nga Gjykata e Apelit Durrës dhe çështja u kthye për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan vendosi rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj e në prova. Mbi ankimin e kërkuarit Gjykata e Apelit Durrës vendosi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe mbi rekursin Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e tij. Në vijim kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së aksesit lidhur me standardin e arsytimit të vendimit – Kërkuesi pretendoi mosmarrjen dijani për datën dhe orën e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit për shkak të mosnjoftimit sipas KPC-së. Në situatën ku rezultoi se kërkuesi nuk ka qenë i pranishëm në gjykimin e zhvilluar në gjykatën e apelit dhe se e ka ngritur këtë pretendim përpara Gjykatës së Lartë, i takonte kësaj të fundit që të verifikonte bazueshmërinë në themel të këtij pretendimi me natyrë kushtetuese, për sa kohë që prania fizike në procesin gjyqësor lidhet drejtpërdrejt me garantimin e të drejtave të tjera procedurale të palëve në këndvështrim të së drejtës për proces të rregullt. Referuar pretendimeve të parashtruara në Gjykatën e Lartë për cenim të së drejtës për t'u njoftuar dhe dëgjuar në gjykatën e apelit, kjo e fundit, në ushtrim të funksionit të saj, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në këtë drejtim. Mungesa e pasqyrimin në vendim të shkaqeve të paraqitura nga kërkuesi në aktin "Pretendime", të depozituar pas publikimit të datës së seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë, si dhe mosdhënia atyre përgjigje të arsyetuar dhe pse këto shkaqe janë dukshëm me natyrë kushtetuese, sjell cenim të së drejtës së aksesit. Gjykata e Lartë është shprehur, se çështja është shqyrtuar në prani të palëve ndërgjyqëse, ndërkohë që, siç konstatohet nga aktet e administruara në gjykim dhe nga vetë përmbajtja e vendimit të gjykatës së apelit, gjykimi në atë gjykatë është bërë në mungesë të të dyja palëve ndërgjyqëse. Kjo e dhënë e gabuar në vendimin e Gjykatës së Lartë është e tillë që vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt edhe në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit. Gjykata çmon se pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit në Gjykatën e Lartë janë të bazuara.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin pjesërisht të kërkesës (tre gjyqtarë u shprehën me mendim pakice).

E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm; - E drejta e barazisë së ligjit; - E drejta për tu gjykuar nga një gjykatë e paanshme

FJALË KYÇE

**Interes i drejtpërdrejtë/
rivendosje e të drejtës së pretenduar/kriteri i paplotë/
dhënie informacioni/
pamundësi objektive**

Gjykata vlerësoi se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae* në ankimin kushtetues individual, pasi nuk ka arritur të provojë interesin e tij të drejtpërdrejtë dhe individual për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

Bardhyl Ibra, (konstatim i cënimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor) - vendimi nr. 51, datë 25.09.2025

Faktet

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë me ankesë kundër ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (sot Këshilli i Lartë Gjyqësor), ministrit të Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, me objekt dhënien e informacionit të kërkuar prej tij në lidhje me identitetin e një gjyqtari. Pas mospranimit të këtij ankimi, me arsyetimin se kërkesa nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj, kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit. Ndërkohë, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cënimit të afatit të arsyeshëm, për të cilën Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë, duke vlerësuar se standardi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk cenohet kur gjykata është në pamundësi objektive.

Kundër këtij vendimi kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se në rastin e kërkuesit rezulton se ai i ka përdorur mjetet juridike në dispozicion, sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së, me qëllimin për të siguruar përshpejtimin e gjykimit të ankimit të tij nga Gjykata Administrative të Apelit dhe për të pasur një vendim të arsyetuar për shkaqet e ankimit të tij. Në këto kushte, për sa kohë që shqyrtimi i çështjes së kërkuesit nga ajo gjykatë ka përfunduar, çka do të thotë se është realizuar qëllimi që ka synuar të arrijë kërkuesi përmes këtyre mjeteve juridike, Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka më interes në këtë gjykim kushtetues. Për rrjedhojë, në këto kushte, kriteri i interesit të kërkuesit për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues nuk konsiderohet i plotësuar, pasi për sa kohë që ai ka marrë përgjigje përfundimtare nga gjykata e apelit, konsiderohet se është rivendosur e drejta e pretenduar që synonte të mbronte nëpërmjet këtij procesi.

Në këto kushte, Gjykata çmoi se kërkesa e kërkuesit duhet të rrëzohet.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

E drejta për proces të rregullt ligjor

FJALË KYÇE

Ekzekutim vendimi/ kërkesë për përshpejtim të gjykimit/ afat i arsyeshëm gjykimi/ sekuestro konservative/ kompleksitet i çështjes /parashtrime shtesë/rrethanë e re/ zhdëmtim/dëm jopasuror/ kostot e shpenzimit

Gjykata Kushtetuese ka theksuar se, ajo nuk vepron si Gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme.

“Zyra e përmbarrimit privat ARB” Sh.p.k. (cenimi i së drejtës së aksesit lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor) - vendimi nr. 52, datë 07.10.2025

Faktet

Kërkuesja shoqëria “Zyra e Përmbarrimit Privat ARB” sh.p.k., ka lidhur kontratë shërbimi me KESH (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare) për kryerjen e shërbimit përmbarrimor për ekzekutimin e vendimit nr. 9031 akti, datë 13.09.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për faturat tatimore të shitjes sipas këtij urdhëri ekzekutimi. Pas lajmërimit për ekzekutimin vullnetar, kërkuesja ka lëshuar urdhrin për vënien e sekuestros konservative bankave të nivelit të dytë. Në vijim i është drejtuar gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë me padi kundër Bankës së Tiranës, që ta shpërblejë për dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga veprimet me faj; fitimin e munguar dhe kamatat ligjore deri në datën e ekzekutimit të këtij vendimi. Pas rrëzimit nga kjo gjykatë, kërkuesja iu drejtua gjykatës së apelit, ku kjo e fundit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtij vendimi, kërkuesja më datë 14.09.2017, ka paraqitur rekurs në gjykatën e lartë. Në datën 14.12.2020 kërkuesja ka paraqitur kërkesë pranë kësaj gjykate për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit të çështjes bazuar në nenet 399/1-399/12 të KPC-së. Më datë 21.12.2020, kancelari i gjykatës së lartë ka njoftuar kërkuesen se kërkesa nuk është nënshkruar nga një avokat, kriter i parashikuar nga neni 474 të KPC-së. Në vijim, në datën 30.12.2020 kërkuesja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, të nënshkruar si nga ajo, ashtu edhe nga një avokat. Pas kësaj kërkesë, më datë 01.04.2021 kërkuesja është njoftuar për bashkimin e dy çështjeve dhe pritjen për shqyrtim të tyre. Më datë 21.04.2021, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë, me objekt konstatimin e: shkeljes së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj; shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile të vitit 2017 dhe 2020; mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura. Më datë 01.11.2021, Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës për kohëzgjatje të paryeshme të procesit në Gjykatën e Lartë, si të pabazuar.

Në datën 07.03.2022 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit të gjykatës së lartë, ku ka vendosur moskalimin e kësaj çështje për shqyrtim, pavarësisht se përbënte një rrethanë të re. Në datën 24.02.2023 kërkuesja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë parashtrime shtesë në lidhje me rekursin e saj dhe në datën 25.04.2024 ka paraqitur, po para kësaj gjykate, kërkesë me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes; konstatimin e statusit të viktimës përgjatë procesit gjyqësor si dhe shpërblimin e dëmit si pasojë e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Pas njoftimit për të metat e kërkesës, konkretisht mungesën e nënshkrimit nga avokati përfaqësues dhe të aktit të përfaqësimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, përtej rradhës së pritjes për gjykim, bazuar në nenin 399/7, pika 3, të KPC-së ka vendosur pushimin e shqyrtimit të kërkesës për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e gjykimit. Ndërsa, përsa i përket rekursit të kërkueses, Kolegji Civil i kësaj gjykate vendosi mospranimin duke argumentuar se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së.

Në datën 24.12.2024 kërkuesja iu drejtua sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka pushuar shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e cenimit, duke kërkuar edhe konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv, konstatimin e statutit të viktimës, si dhe zhdëmtimin në përputhje me ligjin. Gjykata më datë 05.03.2025 vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në datën 25.02.2025 kërkuesja iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual për kundërshtimin edhe të vendimit të gjykatës së lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit të saj, ku, kjo Gjykatë vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në datën 07.10.2025 Gjykata vendosi bashkimin e dy çështjeve të mësipërme, pasi kishin lidhje me njëra-tjetrën.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit – Gjykata vlerësoi se, argumentet mbi të cilat është mbështetur qëndrimi i Gjykatës së Lartë, nuk rezultojnë të jenë arbitrare, alogjike apo kontradiktore ose që vendimi të jetë i paqartë në përmbajtjen dhe vlerësimin e shkaqeve të parashtruara përpara asaj gjykate nga kërkuesja. Për rrjedhojë, vendimi i Kolegjit Civil nuk vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të aksesit dhe standardit të arsytimit dhe vetëm fakti se është vendosur mospranimi i rekursit të kërkueses nuk është i mjaftueshëm në këndvështrimin kushtetues për të vënë në dyshim procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

E drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm

FJALË KYÇE

Urdhër ekzekutimi/ kërkesë për përshpejtim të gjykimit/ afat i arsyeshëm/ sekuestro konservative/ kompleksitet i çështjes

Edhe pse çështja mund të mbartë kompleksitet gjatë gjykimit të saj në gjykatat e faktit, gjykimi në gjykatën e ligjit nuk mund të thuhet se paraqet të njëjtat elemente kompleksiteti.

Gjykata, në konsideratë edhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së lidhur me disa çështje kundër Shqipërisë, çmon se edhe vetëm kohëzgjatja në tërësi e gjykimit në rastin konkret përbën shkak të mjaftueshëm për të konstatuar tejzgjatje të procedurave, për rrjedhojë kërkeses i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

Shoqëria “Zyra e Përmbarrimit Privat ARB” sh.p.k. (cenimi i së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm për shkak të tejzgjatjes së gjykimit në Gjykatën e Lartë) - vendimi nr. 53, datë 09.10.2025

Faktet

Kërkuesja, shoqëria “Zyra e Përmbarrimit Privat ARB” sh.p.k., ka lidhur kontratë shërbimi me KESH (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)-in për kryerjen e veprimeve përmbarrimore të urdhrimit të ekzekutimit. Pas lajmërimit për ekzekutimin vullnetar, kërkuesja lëshoi urdhrin për vënien e sekuestros konservative bankave të nivelit të dytë. Në vijim iu drejtua gjykatës me kërkesë-padi kundër bankës, për shkak se mosekzekutimi i urdhrimit të ekzekutimit i dëmtoi reputacionin e konsoliduar në treg. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi rrëzimin e kërkesë-padisë, vendim ky që u la në fuqi nga gjykata e apelit mbi ankimin e kërkueses. Mbi rekursin e kërkueses të datës 13.02.2019 ende nuk ka një vendimmarrje. Në datën 26.03.2021 kërkuesja iu drejtua Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes dhe në datën 10.06.2021 iu drejtua me ankim kushtetues Gjykatës dhe kërkoi konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile dhe shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Gjykata, me vendimin nr. 39, datë 09.12.2021 vendosi rrëzimin e kërkesës. Në vijim Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vendosi rrëzimin e kërkesës për përshpejtimin e procedurave. Në datën 18.07.2022 kërkuesja iu drejtua sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit dhe detyrimin e Gjykatës së Lartë për rishqyrtimin e kërkesës. Gjykata vendosi moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Në datën 25.04.2024 kërkuesja iu drejtua Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile. Gjykata e Lartë vendosi rrëzimin e kërkesës dhe në datën 24.12.2024 kërkuesja iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues.

Vlerësimi i Gjykatës

Shqyrtimi i çështjes brenda një afati të arsyeshëm – Gjykata konstatoi se për shqyrtimin e çështjes kanë kaluar rreth 11 vjet, ndërsa nga regjistrimi i saj në Gjykatën e Lartë rreth 6 vjet dhe nuk ka një vendimmarrje. Gjithashtu, analizoi rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi. Gjykata konstatoi se kërkuesja nuk rezultoi të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes. Në lidhje me kompleksitetin e çështjes, mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës civile dhe nisur nga natyra e gjykimit në Gjykatën e Lartë, Gjykata vlerëson se edhe pse në dukje çështja mund të ketë elemente kompleksiteti, kjo nuk ka ndikuar në kohëzgjatjen e procesit në atë gjykatë. Sa i takon sjelljes së autoriteteve, Gjykata konstaton se për çështjen është zgjedhur gjyqtari relator A.K., por nuk rezultoi të jetë planifikuar një datë për shqyrtimin e rekursit dhe se aktualisht është në fazë studimi. Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkueses lidhet me ngarkesën në Gjykatën e Lartë të shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi. Për sa i takon rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesja, Gjykata eidenton se, sikurse kanë arsyetuar gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, nuk ka rezultuar që kërkuesja të ketë pësuar dëm pasuror nga veprimet e palës së paditur, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se çështja konkrete është e një natyre të tillë që interesi i kërkueses nuk rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore, megjithatë mungesa e shqyrtimit të saj nga Gjykata e Lartë pas 6 vjetësh ka cenuar të drejtën e kërkueses për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin pjesërisht të kërkesës.

E drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm

FJALË KYÇE

Marrëdhënie pune/ zgjidhje e kontratës/ shkaqe të justifikuara/ dëmshpërblim/ përshpejtim i gjykimit/ afat i arsyeshëm/ interesa vetjakë e jetësorë

Gjykata, referuar qëndrimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vëren se një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet si një kohë e arsyeshme dhe se palët në mosmarrëveshjet civile që nuk kërkojnë ndonjë trajtim të veçantë prioritar kanë megjithatë të drejtë, sipas nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, për një proces brenda një afati të arsyeshëm dhe ato nuk janë të detyruara të tregojnë, për këtë qëllim, se u është shkaktuar ndonjë dëm i veçantë ose shtesë nga vonesat procedurale.

Bahrije Lluka, (cenimi i së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm për shkak të tejzgjatjes së gjykimit në Gjykatën e Lartë) - vendimi nr. 54, datë 09.10.2025

Faktet

Kërkuesja e punësuar si infermiere në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor të Pukës ka ndërprerë marrëdhëniet financiare me këtë institucion në vitin 2016 si pasojë e zgjidhjes së kontratës së punës për shkak të ristrukturimit. Në vijim kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku ka kërkuar deklarimin e pavlefshmërisë së veprimeve administrative për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara, rikthimin në vendin e punës, si dhe detyrimin e të paditurës (punëdhënësi) për dëmshpërblimet sipas Kodit të Punës. Kjo gjykatë pas shpalljes së moskompetencës ia ka dërguar çështjen Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, e cila ka vendosur pranimin e pjeshëm e padisë, duke detyruar palën e paditur të shpërblejë paditësen me 2 paga mujore për mosrespektim të procedurës së njoftimit, dhe rrëzimin e pjesës tjetër të padisë. Mbi ankimin e ushtruar, Gjykata Administrative e Apelit ka detyruar palën e paditur që t'i paguajë kërkueses 11.5 paga mujore si shpërblim për vjetërsi në punë dhe lënien në fuqi të vendimit për pjesën tjetër. Në vitin 2019 kërkuesja ka paraqitur rekurs pranë Gjykatës së Lartë. Në vitin 2023 e në vitin 2024, në pritje të shqyrtimit të çështjes së saj, kërkuesja i është drejtuar asaj gjykate me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit, për të cilën Kolegji Civil ka vendosur rrëzimin. Në vitin 2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

Shqyrtimi i çështjes brenda një afati të arsyeshëm – Gjykata konstatoi se kohëzgjatja tërësore e procesit deri në këtë fazë të tij është mbi 9 vjet, duke tejkaluar kështu afatin 2-vjeçar të gjykimit, të përcaktuar nga KPC-së dhe atë 90-ditor, të parashikuar nga ligji nr. 49/2012 për gjykimin administrativ, si dhe në vijim analizoi rrethanat e veçanta të çështjes konkrete në raport me kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi.

Përsa i takon sjelljes së kërkueses Gjykata konstatoi se kërkuesja nuk është bërë shkak për vonesat në gjykim, ka paraqitur prova të plota dhe nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për shtyrje të gjykimit. Në lidhje me kompleksitetin e çështjes, objekti i gjykimit është marrëdhënia e punësimit dhe shpërblimi i dëmit, që, për shkak të pasojave me natyrë sociale dhe financiare, përbën interes vetjak dhe jetësor për kërkuesen e cila është pensioniste, ndaj duhet të trajtohet me përparësi. Për sa i takon sjelljes së autoriteteve, Gjykata konstaton se një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet e arsyeshme kur argumenti i vetëm për vonesën është reforma në sistemin e drejtësisë dhe ngarkesa e gjyqtarëve e krijuar për këtë shkak dhe faktorë të tillë të një natyre të përgjithshme mund të merren parasysh në një masë të përshtatshme në përcaktimin e çdo kohëzgjatjeje të procedurave në një çështje të veçantë, por nuk janë të afta, në vetvete, të justifikojnë vonesa të një mase të tillë. Në lidhje me atë çfarë rrezikon kërkuesja Gjykata ka vlerësuar se është argumentuar dhe provuar rreziku për interesat e kërkueses, duke pasur parasysh se ajo është pensioniste dhe në një moshë të caktuar. Gjykata, duke pasur parasysh periudhën prej 6 vjetësh gjatë së cilës çështja është në pritje të shqyrtimit në Gjykatën e Lartë, arrin në përfundimin se ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Në përfundim, Në këto kushte, Gjykata vlerësoi se pretendimet e kërkueses janë të bazuara duke konstatuar cenimin e së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe detyrimin e Gjykatës së Lartë për të shqyrtuar çështjen me përparësi

Gjykata pranoi kërkesën edhe për kërkimin mbi shpenzimet gjyqësore, të paraqitur në ankimin kushtetues individual, sipas faturës tatimore, në masën 25.000 lekë.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës.

E drejta për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme - E drejta për t'u mbrojtur - Parimi i mosdënimit pa ligj - Parimi i prezumimit të pafajësisë - E drejta për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve

FJALË KYÇE

Afat i arsyeshem gjykimi/ akt ekspertimi/ dhomë këshillimi/ kohëzgjatje gjykimi/ përsëritje shqyrtimi gjyqësor/ ne bis in idem/ gjykatë e paanshme/ avokat i zgjedhur/ avokat kryesisht/ deklarata fajësie të organeve publike/ përgjegjësi civile dhe Penale/ pyetje dëshmitarësh

Në vlerësimin e Gjykatës, në kundërshtim nga sa kërkuasi pretendon, arsyetimi i gjykatave nuk rezulton arbitrar në këndvështrimin kushtetues, për sa kohë që kërkuasi ka qenë objektivisht në gjendje, qoftë edhe përmes mbrojtësve të tij, të kuptojë përmbajtjen e normave penale për veprimet ose mosveprimet që do e bënin atë jo vetëm penalisht, por edhe civilisht përgjegjës, sipas parashikimeve të KPP-së.

Kastriot Ismailaj (dënim penal për mashtrim e pastrim parash) - vendimi nr. 55, datë 10.10.2025

Faktet

Kërkuasi ka krijuar disa shoqëri në Shqipëri. Në cilësinë e ortakut dhe përfaqësuesit ligjor të njëres prej tyre ka lidhur kontratë 2-vjeçare me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH) për mbledhjen nga debitorët e OSSH-së të borxheve dhe kamatave që kishin kaluar afatin prej 90 ditësh. Ndërkohë, Prokuroria e Tiranës ka iniciuar dy procedime penale ndaj kërkuarit, për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, neni 287 i KP-së, pasi dyshohej se, përmes llogarive të shoqërive të krijuara e administruara prej tij, kishte kryer transaksione financiare pa logjikë ekonomike, me burime të ardhurash të dyshuara nga aktivitete të paligjshme kriminale. Vendimet e prokurorisë për pushimin e këtyre çështjeve janë shfuqizuar në vijim nga Prokuroria e Përgjithshme dhe janë bashkuar me tjetër procedim penal të iniciuar ndaj kërkuarit për kryerjen e veprave penale “Mashtrimi” dhe “Pastrimi i produkteve të veprave penale”, në bashkëpunim, më shumë se një herë, të parashikuara nga nenet 143/2, dhe 287/2, të KP-së.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në përfundim të gjykimit ka deklaruar kërkuarin fajtor për veprat e akuzuara dhe e ka dënuar me 11 vjet burgim. Po kështu, gjykata ka bërë konfiskimin e kalimin në favor të shtetit të shumave në dollarë, euro e lekë të gjendura në llogaritë bankare në emër të kërkuarit. Pas ankimit të paraqitur, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit. Kërkuasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

-Për cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme - Gjykata vërejt se pretendimet e kërkuarit për dëshmitë e shtetasve A.S., S.H. dhe O.K. kishin të bënin, në thelb, me besueshmërinë e provës me dëshmitar dhe jo me ekzistencën e shkaqeve të papajtuashmërisë të parashikuara nga neni 156, shkronja “ç”, i KPP-së.

Për sa i takon pretendimit për papajtuashmërinë me rolin e dëshmitarit të shtetasit R.K., jurist e avokat mbrojtës i DIA dhe OSSHE-së në Gjykatën e Arbitrazhit Ndërkombëtar, Gjykata vërejt se, jo vetëm që nuk rezultoi të ketë pasur cilësinë e avokatit të kërkuarit në çështjen në ngarkim të këtij, por as që të jetë detyruar kundër vullnetit të tij të dëshmojë gjatë gjykimit.

Për sa u përket pretendimeve për marrjen e provave në mënyrë të paligjshme, pasi kërkuasi nuk ka qenë i pranishëm gjatë sekuestrimit të akteve Gjykata çmoi se nuk gjenin mbështetje nga pikëpamja kushtetuese.

Për sa u përket pretendimeve të kërkuarit se projekti i ashtuquajtur “Master Data Cleaning” nuk është marrë me procesverbal sekuestrimi e vendimi i prokurorit për sekuestrimin nuk ndodhet në fashikullin e gjykimit, si dhe se e-mail-i bashkëshoqërues i dokumentit “P.&P.”, i depozituar në seancë gjyqësore nga organi i prokurorisë, është fabrikuar, Gjykata vlerësoi se kërkuasi nuk ka arritur të përcaktojë në aspektin kushtetues ndikimin vendimtar të këtyre provave në deklarimin e fajësisë së tij. Sa më lart, Gjykata çmoi se pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme ishin të pazazuara.

-Për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur - Gjykata vërejt se gjykata e rrethit ka marrë masat për balancimin si të së drejtës së kërkuarit për t'u mbrojtur gjatë gjykimit, ashtu edhe për administrimin në kohë të drejtësisë. Po kështu, pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes janë analizuar nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, të cilat kanë dhënë përgjigje të arsyetuara për shkaqet e rrezimit të tyre. Në vlerësimin e Gjykatës, qëndrimi i gjykatave të zakonshme nuk rezultoi arbitrar në këndvështrimin kushtetues, për sa kohë që gjatë procesit gjyqësor kërkuasi i është dhënë mundësia të ketë kohën dhe lehtësitë e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes së vet, si përmes avokatëve të zgjedhur prej tij, ashtu edhe përmes avokatëve të caktuar kryesisht nga gjykata. Për rrjedhojë, Gjykata çmoi se pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe së drejtës për të pasur kohën e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes janë të pazazuara.

Edhe sipas GJEDNJ-së, përdorimi si provë i dëshmimeve të marra gjatë fazës së hetimit, në vetvete, nuk përbën shkelje të nenit 6, paragrafët 1 dhe 3, shkronja “d”, të KEDNJ-së. Edhe pse dënimi i një të pandehuri bazuar vetëm ose kryesisht në dëshmitë e dhëna gjatë fazës hetimore nga dëshmitarët, të cilët ai nuk ka pasur mundësi t'i marrë në pyetje gjatë gjyqimit, passjell kufizim të së drejtës së tij të mbrojtjes, mungesa e pjesëmarrjes në gjykim të një dëshmitari nuk mund të konsiderohet, në vetvete, cenim i së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa kohë që ekzistojnë prova të tjera që mbështesin deklaratimet e tij dhe dënimi nuk mbështetet vetëm në dëshminë e dëshmitarit në mungesë, si provë e vetme e vendimtare.



-Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë - Gjykata vërejt se, duke mbajtur parasysh kontekstin e rrethanave mbi të cilat Prokuroria e Përgjithshme ka reaguar përmes deklaratimeve për shtyp, si dhe faktin se nga materialet e dosjes gjyqësore nuk rezultoi që gjykatat e zakonshme të kenë filluar procesin me paragjykimin se kërkuesi e ka kryer veprën penale ose ta kenë konsideruar atë fajtor përpara dhënies së vendimit përfundimtar për fajësinë e tij, deklaratimet e organit të ndjekjes penale nuk duken se kishin pasur ndikim vendimtar në rezultatin përfundimtar të procesit gjyqësor penal në ngarkim të kërkuesit. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e prezumimit të pafajësisë, si rrjedhojë e publikimit të njoftimeve për shtyp të organit të ndjekjes penale, është i pabazuar.

-Për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj - Gjykata vërejt se kërkuesi ka marrë përgjigje të argumentuar për pretendimet e tij për cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj, referuar natyrës juridiko-civile të marrëdhënies mes palëve, si shkak për cenimin e kësaj të drejte kushtetuese. Në analizë të vendimeve gjyqësore, Gjykata vlerësoi se kërkuesi ka qenë objektivisht në gjendje, qoftë edhe përmes mbrojtësve të tij, të kuptojë përmbajtjen e normave penale për veprimet ose mosveprimet që do e bënë atë jo vetëm penalisht, por edhe civilisht përgjegjës, sipas parashikimeve të KPP-së. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj, ishte i pabazuar.

-Për cenimin e drejtës për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve - Gjykata vërejt se gjykata e rrethit kishte marrë të gjitha masat e bërë të gjitha përpjekjet për njoftimin e thirrjen në gjykim të dëshmitarëve të kërkuar nga kërkuesi, çka ka qenë e pamundur. Ajo ka proceduar me leximin në gjykim të deklaratimeve të dhëna nga një prej këtyre dëshmitarëve gjatë marrjes në pyetje, si dhe ka administruar në gjykim një sërë provash të tjera. Në përfundim të gjyqimit, gjykata e rrethit ka deklaruar fajtor dhe dënuar kërkuesin për veprat penale të akuzuara, duke e mbështetur vendimmarrjen e saj në tërësinë e provave të administruara në gjykim, për të cilat kërkuesit i është dhënë mundësia të kundërshtojë përmbajtjen e tyre. Pretendimet e tij për cenimin e së drejtës për thirrjen e dëshmitarëve në gjykim janë vlerësuar në vijim nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, të cilat kanë dhënë përgjigje të arsyetuara për shkaqet e rrëzimit të tyre. Gjykata vërejt se deklaratimet e dhëna nga shtetasi E.M. gjatë hetimeve paraprake e të lexuara në gjykim nuk kanë qenë vendimtare në përcaktimin e fajësisë së kërkuesit, për sa kohë që vendimmarrja e gjykatave të zakonshme për dënimin e tij ishte mbështetur në një sërë provash, për të cilat kërkuesi kishte pasur mundësi të parashtronte pretendimet e tij dhe t'i kundërshtonte ato pa u vënë në kushte pabarazie dhe pa iu mohuar e drejta e mbrojtjes në kuptimin kushtetues. Ndaj, vendimet e gjykatave të zakonshme nuk rezultoi arbitrare në këtë drejtim, në kuptimin që të binin ndesh me konceptimin e gjyqimit të drejtë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerësoi se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për të marrë në pyetje dëshmitarët ishin të pabazuara.

Vendimmarrja

Gjykata, njëzëri, vendosi rrëzimin e kërkesës.

E drejta e aksesit - Standardi i arsytimit të vendimit

FJALË KYÇE

Shoqëri huamarrëse jobankare/ shoqëri në administrim/ vendim i administratorëve/ ligj i veçantë/ urdhër gjyqësor ekzekutimi/ titull ekzekutiv/rivendosje në afat/ res judicata

Gjykata çmon të ritheksojë se një vendim i gjykatës së apelit konsiderohet si i formës së prerë në kuptim të fuqisë ekzekutive, por ai nuk përbën një vendim përfundimtar me fuqinë e gjësë së gjykuar (res judicata) nëse palët kanë përdorur mjetet e zakonshme të ankimit. Pra, në aspektin formal, gjë e gjykuar nënkupton mosankimueshmërinë e vendimit gjyqësor përmes mjeteve të zakonshme, përfshirë edhe të rekursit në Gjykatën e Lartë.

Gjykata vlerësoi se ajo mënyrë të vepruarit nga gjykatat e zakonshme në procesin gjyqësor të kundërshtuar ka bërë që kërkesit të mos kenë marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet e tyre në lidhje me (pa)vlefshmërinë e titujve ekzekutivë dhe, për rrjedhojë, edhe të veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, duke iu cenuar atyre e drejta e aksesit.

Shoqëria “Siontis” S.A., Shoqëria “Design and Construction Siontis” S.A., Christos Siontis (Kristos Siontis) (cenimi i së drejtës së aksesit lidhur me standardin e arsytimit të vendimit dhe kthim për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit) - vendimi nr. 56, datë 10.10.2025

Faktet

Kërkesit ishin debitorë ndaj shoqërisë huamarrëse jobankare “Gjallica”, ndaj të cilëve Gjykata e Tiranës lëshoi urdhra ekzekutimi, të bazuar në vendime të administratorëve të shoqërisë të konsideruara si tituj ekzekutivë. Gjatë ekzekutimit, Zyra Përmbartimore Elbasan vendosi sekuestro mbi mjete dhe makineri të kërkesit të tretë, pavarësisht se ky ishte vetë kreditor në një tjetër procedim ekzekutimi.

Kërkesi i tretë kundërshtoi sekuestron dhe kërkoi pezullimin e titullit ekzekutiv, anulimin e vendimeve të administratorëve dhe detyrimin e përmbartimit të ekzekutojë vendimin në favor të tij. Të tre kërkesit paraqitën kërkesë në Gjykatën e Apelit Durrës për rivendosje në afat të padisë. Apeli pranoi edhe ndërhyrjen kryesore të kërkesit të tretë dhe bashkoi çështjet, por pas shqyrtimit i rrëzoi paditë.

Gjykata e Lartë e prishi këtë vendim dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila i ndau kërkimet duke gjykuar veçmas rivendosjen në afat nga themeli. Kërkesa për rivendosje në afat u rrëzua, dhe Gjykata e Lartë më pas e pushoi gjykimin mbi këtë pjesë. Ndërsa kërkimet mbi themelin e mosmarrëveshjes u rrëzuan në të dy shkallët, dhe kërkesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese.

Vlerësimi i Gjykatës

Për legjitimitimin ratione materiae mbi pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme - Gjykata vlerësoi se pjesëmarrja në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar rekursin e kërkesve, e dy gjyqtarëve të asaj gjykate të cilët kanë marrë pjesë në kolegjin që ka shqyrtuar më parë rekursin e tyre në procesin gjyqësor për rivendosjen në afat të padisë, nuk sjell a priori cenim të parimit të paanshmërisë, pasi çdokush mund të vërë në lëvizje të njëjtën gjykatë dhe të njëjtët gjyqtarë për çështje të ndryshme. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkesve është haptazi i pabazuar.

Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit - Gjykata Administrative e Apelit ka rrëzuar padinë e kërkesve, pa e shqyrtuar atë në themel, me arsytimin se ishte parashkruar, duke u bazuar për këtë në një vendim gjyqësor, i cili jo vetëm nuk ishte përfundimtar me fuqinë e gjësë së gjykuar (res judicata), për shkak se ndaj tij ishte paraqitur rekurs nga kërkesit, por edhe se më vonë ai u prish nga gjykata më e lartë. Ky qëndrim i Gjykatës Administrative të Apelit u gjet i drejtë nga Gjykata e Lartë, ndonëse ajo, për më tepër, atë vendim gjyqësor të konsideruar si pengesë për shqyrtimin në themel të padisë (vendimin nr. 49/2016 të Gjykatës Administrative të Apelit) e kishte prishur dhe ajo çështje ishte pushuar. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë nuk ka vepruar në përputhje me funksionin e saj si gjykatë e ligjit, në kuptim të nenit 141 të Kushtetutës, duke mos kontrolluar mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykata e apelit, për më tepër, edhe në kuptim të vendimmarrjes së mëparshme të vetë asaj gjykate.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi njëzëri, pranimin e kërkesës.

E drejta për proces të rregullt ligjor

FJALË KYÇE

Shpenzimet gjyqësore / plotësim vendimi/afat dy-mujor/nenet 80 e 28 të ligjit nr. 8577/2000/ Neni 14 i Rregullores, pika 4

Për sa i takon subjektit që ngarkohet për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit, Gjykata ka vënë në dukje se në gjykimin kushtetues individit kërkon të mbrojtë të drejtat themelore të shkelura si pasojë e veprimtarisë së autoriteteve publike, ku përfshihet edhe ajo e gjykatave të zakonshme, që i kanë pasjellë atij cenimin e të drejtave themelore, ndaj përgjegjësia në këtë gjykim i takon vetë shtetit.

Elton Qyno (saktësim dhe plotësim në vendimin e Gjykatës Kushtetuese pas miratimit të shpenzimeve gjyqësore) - vendimi nr. 57, datë 14.10.2025

Faktet

Kërkuesi në datën 14.06.2024 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual me objekt shfuqizimin e vendimeve gjyqësore për lejimin e kontrolleve personale dhe të vendeve (banesë dhe vendi i punës), për sekuestrimin e provave materiale (sende dhe të dhëna kompjuterike) dhe vendimit të prokurorit për sekuestrimin e dy aparateve telefonike, si dhe shkatërrimin e të gjitha kopjeve të të dhënave të nxjerra nga pajisjet e sekuestruara.

Në parashtrimet përpara seancës publike me praninë e palëve, kërkuesi, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, ka kërkuar rimbursimin e shpenzimeve të përfaqësimit, në rastin eventual të pranimit të ankimit kushtetues individual.

Gjykata, me vendimin nr. 21, datë 22.04.2025, kishte vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesës, shfuqizimin e vendimeve gjyqësore që kanë lejuar sekuestrimin e të dhënave kompjuterike të nxjerra nga provat materiale të sekuestruara gjatë kontrollit të banesës dhe të vendit të punës së kërkuesit, si dhe asgjësimin e të dhënave kompjuterike të sekuestruara me këto vendime. Në datën 28.05.2025 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë, me objekt plotësimin e vendimit nr. 21/2025 lidhur me shpenzimet e përfaqësimit.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata çmon se kërkimi i kërkuesit për shpenzimet gjyqësore është paraqitur brenda afatit, pasi ai është depozituar përpara marrjes së vendimit për pranimin e ankimit kushtetues individual. Në lidhje me masën, Gjykata, duke marrë në konsideratë faktin se gjykimi kushtetues i përfunduar me vendimin nr. 21/2025 ka qenë relativisht kompleks, se çështja ka të bëjë me kundërshtimin e vendimeve gjyqësore të fazës së hetimit penal, numrin e seancave të zhvilluara në Gjykatë dhe zhvillimin e disa prej tyre në seancë publike me praninë e palëve, mungesën e formimit dhe të përvojës juridike për të kuptuar çështjen (profesion gazetar), si dhe numrin e pretendimeve të pranuar nga Gjykata, vlerëson masën e shpenzimeve të përfaqësimit në vlerën 200.000 lekë. Detyrimi për pagimin e shpenzimeve të përfaqësimit i ngarkohet Ministrisë së Financave.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e pjesshëm të kërkesës*.

* Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit përfundimtar nr. 21, datë 22.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese, me plotësimin e dispozitivit: "Shpenzimet e përfaqësimit të kërkuesit në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë i ngarkohen Ministrisë së Financave".

E drejta për gjykim të drejtë – Parimi i sigurisë juridike

FJALË KYÇE

Pension i parakohshëm/ ushtarak i Forcave të Armatosura/ ligji i zbatueshëm/ llogaritje e masës së pensionit/ përkeqësim i situatës financiare/ kufizim i përfitimit/ arbitraritet i zbatimit të ligjit

Parimi i sigurisë juridike nuk shfaqet asnjëherë si i tillë në vetvete, por shoqërohet me mbrojtjen e të drejtave të fituara, vazhdimësinë ligjore, qartësinë dhe përcaktueshmërinë në normimin e marrëdhënieve juridike dhe respektimin e pritshmërive.

Në drejtim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se ai përfshin edhe ndalimin e fuqisë prapavepruese të normave juridike, i cili nënkupton se është e pamundur të gjykohej, sipas normave ligjore në fuqi, sjellje njerëzore, fakte ligjore ose marrëdhënie ligjore që kanë ndodhur përpara se këto norma të hynin në fuqi.

Isuf Dashi (cenimi i të drejtës për pension të parakohshëm si pasojë e interpretimit të ndryshëm nga gjykatat të ligjit material të zbatueshëm) - vendimi nr. 59, datë 16.10.2025

Faktet

Kërkuesi oficer aktiv në Forcat e Armatosura prej vitit 1982 dhe i dalë në rezervë në datën 01.09.2004, pas trajtimit me pagesë kalimtare përfitoi pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi deri në vitin 2006. Me vendim të DRSSH (Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore)-së, Berat i caktoi pension të parakohshëm në masën 16.480 lekë në muaj, me të drejtë pagese nga data 01.09.2006, bazuar në ligjin nr. 8087, datë 13.03.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë". Kërkuesi iu drejtua DRSSH-së, Berat dhe kërkoi rillogaritjen e pensionit, por drejtoria u shpreh se llogaritja dhe rillogaritja e pensionit të parakohshëm ishin në përputhje me ligjin dhe me vendimin nr. 2, datë 18.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese (Gjykata). Kërkuesi iu drejtua gjykatës me padi dhe kërkoi revokimin e vendimit të DRSSH-së, Berat, rillogaritjen, si dhe ricaktimin dhe pagesën e masës së pensionit të parakohshëm nga data 01.09.2006 deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie, si dhe pagesën e diferencave midis masës së pensionit sipas ligjit nr. 9210/2004 dhe pensionit të paguar, së bashku me kamatëvonesat nga data 01.09.2006 deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, vendosi pranimin e padisë. Mbi ankimin e paraqitur nga DRSSH-ja, Berat, Gjykata Administrative e Apelit vendosi ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë së kërkuesit. Mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vendosi mospranimin e tij. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë lidhur me parimin e sigurisë juridike – Gjykata çmon, se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi jepet në konsideratë të natyrës së punës të ushtarakëve, të cilët pas ndërprerjes së karrierës, me ose pa dëshirën e tyre, e kanë të vështirë të gjejnë një vend pune të një niveli të krahasueshëm me funksionet që ushtronin dhe për këtë ligjëvënasi parashikoi krijimin e një sistemi përfitimesh suplementare që të garantohej ruajtja e një niveli të krahasueshëm jetese dhe ekonomik për ushtarakët e Forcave të Armatosura. Në këtë këndvështrim, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi mbrohet nga parimi i sigurisë juridike. Gjykata konstaton se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka shqyrtuar ligjëshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet në bazë të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ, si dhe nuk e ka llogaritur masën e pensionit sipas kushteve e kriterëve të parashikimeve ligjore në fuqi për atë periudhë, prandaj në vlerësimin e Gjykatës, vendimi i gjykatës së apelit nuk duket se ka përmbushur konceptin e një gjykimi të drejtë. Gjykata vëren se përmbajtja e ligjit, si dhe mënyra e interpretimit të tyre nga gjykatat nuk rezultojnë të jetë analizuar nga Gjykata e Lartë dhe se nuk shprehet se përse ligji i identifikuar nga gjykata administrative e shkallës së parë konsiderohet si i zbatueshëm në rastin konkret dhe ai që është identifikuar nga gjykata e apelit është i pazbatueshëm. Gjykata e Lartë nuk duket se u ka dhënë përgjigje shkaqeve të paraqitura në rekurs për ligjin e zbatueshëm në rastin konkret. Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së pensionit të parakohshëm për shkak të interpretimit të paarsyeshëm të ligjit, në lidhje me periudhën 01.09.2006 - 30.06.2009, është i bazuar.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin pjesërisht të kërkesës.

E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

FJALË KYÇE

Leje legalizim banese/ (ALUIZNI), ASHK/ interesa “vetjakë e jetësorë”/trajtim me përparësi.

Gjykata ka theksuar se neni 48 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, parashikon afatin 30-ditor për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja “a”, i KPC-së). Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

Hismet Drazhi (cenimi i së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm për shkak të tejzgjatjes së gjykimit në gjykatën e apelit) - vendimi nr. 61, datë 21.10.2025

Faktet

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) (sot ASHK) dhe Drejtorisë Vendore të saj, t'i legalizojë objektin “banesë” dhe ta pajisë me leje legalizimi. Kërkesa e pranuar nga Gjykata, është ankimuar nga ASHK-ja dhe ndërkohë që çështja ishte në pritje të gjykimit të apelit, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, të cilën, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka rrëzuar. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm - Gjykata vëren se thelbi i çështjes gjyqësore të vënë në lëvizje nga kërkuesi ka të bëjë me pamundësinë e përfundimit të procesit të legalizimit të banesës së tij dhe pajisjen me leje legalizimi. Për natyrën e çështjes, edhe pse nuk lidhet drejtpërdrejt me interesa vetjakë dhe jetësorë, bazuar në shkaqet objektive, se banesa është e vetmja pasuri që ai disponon, si dhe moshën e tij në pension pleqërie, duket se ata janë specifike dhe të mjaftueshëm për të provuar se interesi i tij rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore.

Gjykata duke pasur parasysh periudhën prej 7 vjetësh e 3 muajsh gjatë së cilës çështja është në pritje të shqyrtimit në Gjykatën Administrative të Apelit, arrin në përfundimin se ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, për rrjedhojë vendimi i Gjykatës së Lartë shfuqizohet dhe Gjykata Administrative e Apelit ka detyrimin të shqyrtojë çështjen me përparësi.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi njëzëri, pranimin e kërkesës.

E drejta për proces të rregullt ligjor - Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor e lidhur me të drejtën e aksesit substancial

FJALË KYÇE

Vrasje me paramendim/ rivendosje në afat/ gjykim i drejtë/ neni 420/1 i KPP/ ankim / arsytim de plano/ ekzekutim vendimi/ rishikim i vendimit gjyqësor/ prezumimi “nemo censetur ignorare legem”/ zbatim arbitrar i ligjit

Duke vlerësuar rëndësinë e administrimit të mirë të drejtësisë që neni 420/1 i KPP-së synon, e balancuar kjo me interesat e kërkuarit, i cili me nismën e tij vë në lëvizje gjykatën, Gjykata çmon se interpretimi që gjykatat e zakonshme i kanë bërë neni 420/1 të KPP-së nuk është arbitrar në këndvështrimin kushtetues.

Fatos Metushi (cenim i së drejtës nga gjykatat në drejtim të rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit) - vendimi nr. 62, datë 23.10.2025

Faktet

Kërkuari është dënuar në vitin 2000 me 25 vjet burg nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, pas përfundimit të gjykimit të zhvilluar në mungesë të tij. Vendimi ka marrë formë të prerë dhe ka dalë urdhri për ekzekutimin e tij. Kërkuari është arrestuar në shtetin grek, dhe është ekstraduar për në Shqipëri ku është vënë në dijeni nga autoritetet shqiptare për ekzekutimin e vendimit. Ai i është drejtuar Gjykatës së Rrethit me kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit të fajësisë, duke pretenduar se procedimi penal dhe gjykimi i çështjes penale ishin bërë në kundërshtim me KPP-në, nga ku është vendosur mospranimi i kësaj kërkesë, me argumentin se ajo nuk ishte shoqëruar me ankimin, çka sipas neni 420/1 të KPP-së passillte mospranimin e saj. Gjykata e Apelit Vlorë ka lënë në fuqi vendimin, duke e gjetur atë të drejtë dhe të bazuar në ligj. Kërkuari ushtroi rekurs dhe më pas paraqiti shtesë të tij. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vendosi mospranimin e rekursit, me arsytimin se vendimet e gjykatave më të ulëta ishin marrë në interpretim e në zbatim të drejtë të ligjit. Ndërsa, për pretendimet në shtesën e rekursit, për rrëzimin nga gjykatat të kërkesës së tij për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, ky Kolegj vlerësoi se, ato nuk mund të merreshin në shqyrtim, pasi i përkisnin një gjykimi tjetër. Kërkuari iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial -Në analizë të vendimmarrjeve gjyqësore përkundrejt parashikimeve ligjore të neni 420/1 të KPP-së, Gjykata vëren se mospranimi nga gjykatat e zakonshme të kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit është rrjedhojë e mosveprimeve në përputhje me përcaktimet ligjore nga ana e kërkuarit. Gjykata vlerësoi se, kërkuari kishte mundësi, qoftë edhe përmes ndihmës së mbrojtësit, të parashikonte pasojën e mospranimit të kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, në zbatim të dispozitave të lartpërmendura të KPP-së, si rrjedhojë e mosshoqërimit të saj me ankimin ndaj vendimit gjyqësor të themelit.

Po kështu, në kundërshtim nga sa kërkuari pretendon, këto gjykata i kanë arsyetuar vendimmarrjet e tyre, duke dhënë përgjigje të arsyetuara për shkakun ligjor të mospranimit të kërkesës për rivendosje në afat, konkretisht mosshoqërimit e saj me ankimin ndaj vendimit penal, si kusht i domosdoshëm për të vijuar me shqyrtimin e themelit të pretendimeve. Gjykata çmoi se pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor ishin të pabazuara.

Vendimmarrja

Gjykata, me shumicë votash, vendosi rrëzimin e kërkesës (tre gjyqtarë u shprehën, me mendim pjesërisht kundër)

E drejta për gjykim të drejtë

FJALË KYÇE

Aksident automobilistik me pasojë vdekjen/ trashëgimtarë ligjorë/ BSHS/shoqëri sigurimesh/ deklaratë noteriale/ vendimi unifikues nr. 12/2007/ dëm pasuror dhe jopasuror/neni 511 i KC-së/ neni 610 i KC-së

Gjykata vlerësoi se mënyra e arsytimit të Gjykatës së Lartë, e cila, nga njëra anë, ka pranuar se ndodhemi përpara shpërblimit të dëmit në një marrëdhënie jashtëkontraktore dhe, nga ana tjetër, u është referuar për zgjidhjen e çështjes dispozitive që rregullojnë marrëdhënie me natyrë kontraktore, e bën kontradiktor vendimin e saj.

Uljana Jeshili, Erind Jeshili (*shpërblim dëmi për humbjen e jetës së familjarit*) - vendimi nr. 63, datë 23.10.2025

Faktet

Kërkuesit, janë trashëgimtarë ligjorë të të ndjerit E.J.(bashkëshortja dhe i biri), i cili ka humbur jetën në një aksident automobilistik. Shoqëria INSIG, e deleguar nga Byroja Shqiptare e Sigurimit (BSHS), e ka njohur si ngjarje sigurimi dhe i ka ofruar kërkueses një vlerë monetare, si shpërblim për dëmin e pësuar. Kërkuesja ka pranuar vlerën dhe ka nënshkruar një deklaratë noteriale që nuk ka pretendime të tjera financiare ndaj shoqërisë së sigurimit.

Pas disa vitesh, kërkuesja e parë, i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar diferencën e dëmit real pasuror dhe jopasuror. Padia është rrëzuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila vlerësoi se detyrimi ishte shuar, duke u bazuar në përmbajtjen e nenit 511 të KC-së. Gjykata e apelit, konkludoi se ai vendim ishte i gabuar, duke arsyetuar se marrëveshja që paraprakisht përjashtoi ose kufizon përgjegjësinë e personit që ka kryer dëm me faj është e pavlefshme, referuar përmbajtjes së nenit 610 të KC-së. Gjykata e apelit konstatoi gjithashtu, se shuma e dhënë nga shoqëria e sigurimit, përmbante vetëm dëmin pasuror, të cilit duhet t'i shtohet edhe dëmi jopasuror, bazuar në vendimin unifikues nr. 12/2007.

Gjykata e Lartë e ka vlerësuar të gabuar, referimin e gjykatës së apelit tek neni 610 i KC-së për të argumentuar pavlefshmërinë e deklaratës noteriale, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë - Gjykata çmoi se Gjykata e Lartë ka gabuar në përcaktimin e fakteve për deklaratën noteriale të nënshkruar nga kërkuesja e parë, duke vlerësuar përmbajtjen e saj si një mënyrë të shuarjes së detyrimit që rrjedh nga marrëdhëniet kontraktore, referuar nenit 511 të KC-së. Deklarata noteriale nuk ka të evidentuar se cili ka qenë detyrimi i subjektit të interesuar si debitor dhe në cilën shifër ose masë ky detyrim është shuar me falje nga kreditori (kërkuesja).

Gjykata vlerësoi se kundërshtimi i vlerës së dëmshpërblimit në këto raste, duhet të vendoset nga gjykata edhe për vlerën e detyrimit, dhe se vetëm përmbushja e tij mund të jetë e aftë të pasjellë shuarjen e detyrimit.

Interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, në rastin në fjalë, i mungon analiza nga pikëpamja e faktit dhe e së drejtës, duke e bërë atë haptazi të paarsyeshëm ose arbitrar.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi njëzëri, pranimin e kërkesës.

**E drejta për proces të rregullt ligjor - E drejta e gjykimit të shkurtuar - E drejta e arsyetimit të vendimit—
Mosgjykimi pa ligj - Barazia përpara ligjit - Parimi i mosdiskriminimit**

FJALË KYÇE

Çmuarja e provave/ siguri juridike/ mosdiskriminim/ cilësim juridik i veprës penale/ gjykim i shkurtuar/ masë dënimi/ zbatim arbitrar i ligjit/ mosdënim pa ligj

Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë.

Gjykata vlerëson se mënyra sesi kanë vepruar prokuroria e më tej gjykatat e juridiksionit, të cilat kanë pasur të gjitha hapësirat ligjore për t'i garantuar kërkuesit të drejtën për të përfutur nga gjykimi i shkurtuar gjatë procesit gjyqësor penal, ka sjellë, në thelb, cenimin e garancive efektive kundër dënimit arbitrar në kuptim të së drejtës kushtetuese të mosdënimit pa ligj.

Renato Sina (mosdënim pa ligj për shkak të refuzimit të gjykimit të shkurtuar, në drejtim të masës së dënimit) - vendimi nr. 64, datë 09.10.2025

Faktet

Midis kërkuesit, babait të tij nga njëra anë dhe vëllezërve T.S. dhe E.S., nga ana tjetër ka ndodhur një konflikt, nga ku pas plagëve të marra, pas disa ditësh ka ndërruar jetë shtetasi E.S. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka akuzuar kërkuesin dhe shtetasit P.S. dhe T.S. për kryerjen e veprës penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, të kryer në bashkëpunim, të mbetur në tentativë (në këtë moment viktimja nuk kishte ndërruar ende jetë), për të cilën parashikohet dënimi jo më pak se 20 vjet ose me burgim të përjetshëm. Prokuroria, pas kryerjes së hetimeve, ka kërkuar kalimin e çështjes për gjykim vetëm për kërkuesin për “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare”, të kryer në bashkëpunim, për cilësimin e së cilës ka administruar si prova certifikatat personale të kërkuesit, babait të tij dhe viktimës. Më pas, sipas kërkesës së prokurorisë, çështja penale i ka kaluar për gjykim Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e cila ka caktuar datën 27.07.2017 për zhvillimin e seancës gjyqësore, ku mbrojtësi i kërkuesit ka kërkuar: shpalljen e moskompetencës lëndore të saj; ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, si të kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme; zhvillimin e procesit me procedurën e gjykimit të shkurtuar. Kjo seancë gjyqësore është shtyrë 2 herë (jo nga kërkuesi) dhe gjykata në seancën e datës 02.11.2017 ka vendosur refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar duke arsyetuar se tashmë kishte hyrë në fuqi ligji nr. 35/2017, me të cilin kishte ndryshuar edhe pika 2 e nenit 403 të KPP-së. Në përfundim, gjykata e shkallës së parë, mes të tjerave, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për “Vrasje me dashje”, sipas nenit 76 të Kodit Penal e masë dënimi 20 vjet burgim. Pas ankimit nga Prokuroria dhe nga kërkuesi, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka vendosur ndryshimin e vendimit vetëm në lidhje me masën e dënimit duke e zvogëluar atë. Pas ushtrimit të rekursit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj - Gjykata vlerësoi të ritheksojë efektet që sjell gjykimi i shkurtuar për sa i përket masës së dënimit. Zgjedhja e gjykimit të shkurtuar, si rit procesual, ndikon mbi masën ose llojin e dënimit që caktohet nga gjykata, për rrjedhojë kjo e drejtë procedurale ndikon drejtpërsëdrejti në të drejtën materiale të mosdënimit pa ligj. Gjykata vlerëson se mënyra sesi kanë vepruar prokuroria e më tej gjykatat e juridiksionit, të cilat kanë pasur të gjitha hapësirat ligjore për t'i garantuar kërkuesit të drejtën për të përfutur nga gjykimi i shkurtuar gjatë procesit gjyqësor penal, ka sjellë, në thelb, cenimin e garancive efektive kundër dënimit arbitrar në kuptim të së drejtës kushtetuese të mosdënimit pa ligj. Gjykata vlerësoi se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj janë të bazuara, ndaj, çmon se, duhet të shfuqizohet vendimi i Gjykatës së Lartë, pasi duke u bazuar në kompetencat e saj si gjykatë ligji, është në pozicionin e duhur për të shqyrtuar pretendimin e kërkuesit dhe riparuar gabimet e gjykatave më të ulëta.

Gjykata, duke ritheksoar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë, e cila i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të kryer një rol që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, vlerësoi të mos ndalet në analizimin e pretendimeve të tjera të paraqitura nga kërkuesi për procesin gjyqësor penal të lidhura edhe me pretendimet për nenin 403, pika 2, të KPP-së, të ndryshuar, për sa kohë që çështja do të merret sërish në shqyrtim nga Gjykata e Lartë. Në përfundim, Gjykata çmoi se, kërkesa është e pjesërisht e bazuar, ndaj dhe ajo pranohet.

Vendimarrja

Gjykata, njëzëri, vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës.